



**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS**

Nr. 503 prot.

Tiranë, më 16.02 2026

Lënda: Dërgohet raporti dhe anekset e monitorimit të buxhetit për 12 mujorin 2025.

**MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT**


Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, dt.24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, ju dërgojmë bashkëlidhur raportin dhe anekset e monitorimit të buxhetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën janar – dhjetor 2025, plotësuar sipas kërkesave të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS

RAPORTI

I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2025

PËRMBAJTJA:

- Hyrje
- Informacion mbi performancën e programit buxhetor
- Aneksi nr.1 “Raporti përmbledhës i shpenzimeve të Ministrisë/ institucionit buxhetor”
- Aneksi nr.1.1 “Raporti i shpenzimeve të ministrisë/ institucionit buxhetor sipas kapitujve”
- Aneksi nr.1.2 “Shpenzimet buxhetore në total programi dhe total ministrie/ institucioni buxhetor sipas artikujve”
- Aneksi nr.2 “Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit në nivelin e programit të buxhetit”
- Aneksi nr.2.1 “Shpenzimet e programit sipas kapitujve”

- Aneksi nr.3 “Raporti i performancës së produkteve të programit”
- Aneksi nr.3.1 “Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve”
- Aneksi nr.3.2 “Devijacioni i kostos për njësi në vite”
- Aneksi nr.4 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit”

HYRJE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ i pavarur kushtetues, i ngritur në përputhje me nenin 147/d të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Organizimi dhe funksionimi i institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka realizuar monitorimin e buxhetit të vitit 2025 përmes vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, si dhe krahasimit të nivelit faktik të treguesve të performancës me ato të planifikuar. Ky proces ndiqet në vijimësi nga strukturat përgjegjëse, të cilat kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë në funksion të realizimit të objektivave dhe masave të planit strategjik dhe planit të veprimit të ILD-së për vitet 2023-2025.

Ky raport monitorimi pasqyron realizimin e fondeve buxhetore të ILD-së, të detajuar në nivel kategorie të shpenzimeve buxhetore, kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë sigurimin e një informacioni orientues në drejtim të përmirësimit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

Mbështetur në Ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, në zbatim të Udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, më poshtë gjendet informacioni mbi performancën e buxhetit të ILD – së për vitin 2025.

Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e pësuar gjatë vitit 2025:

Buxheti i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë identifikohet me programin buxhetor “Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, kodi "03320”.

Me ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Kuvendi miratoi një total prej 354,600 mijë lekë për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë , të detajuar në :

1. Fondet për Shpenzime korrente në shumën 302,900 mijë lekë,
2. Fondet Shpenzime kapitale në shumën 51,700 mijë lekë,

Ky buxhet u ndryshua si pasojë e rishikimeve gjatë vitit, e konkretisht :

- Në zbatim të Aktit Normativ nr.6, datë 11.06.2025 në grupin e zërave të shpenzimeve për personelin (Paga e sigurime) u pakësuan në total 30,000 mijë lekë.
- Me Aktin Normativ nr.10, datë 08.10.2025, po në grupin e shpenzimeve për paga e sigurime, fondet buxhetore u reduktuan me një total prej 38,000 mijë lekë, nga tepricat e rezultuara për 9 mujorin, si pasojë e vijimit të mosplotësimit të vakancave për pozicionet “Inspektor”, etj.
- Në bazë të konfirmimeve të dërguara nga ana jonë mbi fondet e lira në mbyllje të vitit buxhetor, me Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025, fondet buxhetore u pakësuan:
 - a) Në zërat 600- 601 në vlerën 3,100 mijë lekë,
 - b) Në zërat 602-606 në vlerën 3,900 mijë lekë
 - c) Në zërat 230-231 në vlerën 15,781 mijë lekë.

Për vitin 2025, është miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 10122/1 prot., datë 08.07.2025 rialokimi brenda Zërit “Investime” i fondit prej 602 mijë lekë, në përmbushje të kërkesës sonë për sigurimin e fondit të nevojshëm për rishikimin e projektit për ndërtimin e dhomës së serverave.

Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.6368/1 prot., datë 17.04.2025 është miratuar fondi i veçantë për vitin 2025 në vlerën 300 mijë lekë.

Numri i punonjësve të miratuar në ligj është 101 punonjës, në përputhje me organikën e institucionit, të miratuar me Vendimin nr.28/2020 të Kuvendit, të ndryshuar. Në mbyllje të 12 mujorit 2025, organika e institucionit është plotësuar me 82 punonjës, duke rezultuar me 19 vende të lira, nga të cilat: 4 vende në pozicionin “Këshilltar”, 5 vende në pozicionin “Inspektor magjistrat”, 5 vende për pozicionin “Inspektor jo magjistrat”, 1 vend në pozicionin “Ndihmës inspektor” dhe 4 vende në administratë.

Performanca financiare e programit buxhetor.

Në mbyllje të vitit raportues, shpenzimet faktike të programit buxhetor “Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, janë në vlerën totale 247,817 mijë lekë, duke realizuar në masën 93.8 % buxhetin e rishikuar, nga 92% që ishte ky tregues në mbyllje të vitit 2024.

Shpenzimet faktike të këtij viti janë me ulje në masën 31.5% kundrejt vlerës prej 361,860 mijë lekë të realizuar në vitin 2024; këtu ka ndikuar në mënyrë të veçantë fakti se fondet për investime, të miratuara me Ligjin 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, janë ulur me 21,300 mijë lekë, ose me 29.2%, në krahasim me planin fillestar të vitit 2024.

Realizimi i buxhetit të vitit 2025 për veprimtarinë e ILD – së, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve buxhetore është si më poshtë:

“Shpenzime për paga e sigurime” – (art.600-601),

Buxheti fillestar i miratuar për këtë grup shpenzimesh me ligjin 115/2024 “ Për buxhetin e vitit 2025” është **266,700 mijë lekë**. Gjatë vitit, në zbatim të Akteve Normativë nr.6, nr.10 dhe nr.11, buxheti u pakësua me 64,000 mijë lekë në zërin “600” dhe 7,100 mijë lekë në zërin “601”. Në mbyllje të vitit, plani i buxhetit në zërat 600-601 është **195,600 mijë lekë**.

Për vitin 2025, shpenzimet e këtij grupi, ku përfshihen shpenzimet për paga e sigurime për personelin e organikës dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme janë në vlerën **195,513 mijë lekë**, ose në masën **99.9% kundrejt planit të buxhetit të rishikuar**.

Në krahasim me vitin paraardhës, fakti i vitit 2025 është me rritje në masën 1.7%.

“Shpenzime për mallra e shërbime” – (art. 602),

Me ligjin 115/2024, u miratua një buxhet prej **34,370 mijë lekë**, duke mbuluar tërësisht kërkesat tona buxhetore të paraqitura në PBA 2025-2027. Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025, fondet e kursyera në zërin e planifikuar për udhëtimet jashtë vendit, si dhe për pagesat e honorareve u pakësuan në vlerën 2,300 mijë lekë. Në mbyllje të vitit, plani i buxhetit 602, i ndryshuar, është 32,070 mijë lekë. Si rezultat i mirëmenaxhimit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve sipas zërave analitikë, **shpenzimet faktike të artikullit 602** janë në shumën **28,613 mijë lekë**, me realizim në masën **89.2 % të planit të buxhetit të rishikuar**, Rënia në masën 7.8% e shpenzimeve operative në krahasim me vitin 2024, ka ardhur për arsye se, në shpenzimet faktike të vitit 2024, ndikuan pagesat në vlerën 3,075 mijë lekë të qeramarrjes së ambjenteve për stafin e ILD për shkak të vijimit të punimeve të rikonstruksionit të godinës.

Me fondet buxhetore në dispozicion për vitin 2025, është bërë i mundur mbulimi i nevojave administrative, si:

Shpenzime për shërbimin e sigurisë dhe ruajtjes së objektit në vlerën 6,116 mijë lekë, për faturat mujore të energjisë, ujit, shërbimit postar dhe telefonisë në vlerën 2,927 mijë lekë, shpenzime të udhëtimit brenda e jashtë vendit në vlerën 4,405 mijë lekë , marrje me qera ambjente magazinimi 900 mijë lekë, për kontratat në vazhdim në vlerën 571 mijë lekë, etj.

Gjithashtu, me zërat e parashikuar në regjistrin e Prokurimeve Publike për vitin 2025, janë realizuar procedurat e prokurimeve, si: blerja e karburantit për automjetet në vlerën 1,170 mijë lekë, sigurim jete e shëndeti në vlerën 590 mijë lekë, rinovimi i afatit të licensave të përdoruesve të Sistemit të menaxhimit të ankesave në ILD në vlerën 5,089 mijë lekë, blerje materiale kancelarie në vlerën 1,184 mijë lekë, blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të

zyrës dhe materiale të tjera të përgjithshme zyre në vlerën 800 mijë lekë, materiale pastrimi në vlerën 704 mijë lekë, shërbim interneti në vlerën 120 mijë lekë, shërbim programi financiar në cloud në vlerën 117 mijë lekë, për mirëmbajtjen, larjen, siguracionet dhe taksat vjetore të automjeteve në vlerën 1,333 mijë lekë, shpenzime pritje-përcjellje 1,291 mijë lekë etj.

“ Transferta për org. Ndërkombëtare ” - (art. 605)

Fondi i kërkuar për pagesën për RESIJ (Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit), ku ILD është anëtar që prej qershorit të vitit 2023, të kuotës vjetore prej 5000 Euro. Fondi nuk u realizua , pasi, gjatë vitit 2025, nuk është përcjellë njoftim zyrtar/ dokument financiar për pagesën e detyrimit. Ky fond u pakësua në kuadër të rishikimit të buxhetit me Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025 .

“ Transferta për buxhetet familjare dhe individët ” - (art.606)

Me ligjin 115/2024, u miratua një buxhet prej **1,230 mijë lekë** për mbulimin e kufirit të shpenzimeve të telefonisë celulare për kategoritë e funksionarëve të parashikuar në VKM nr.673, datë 02.09.2020, të ndryshuar. Fondi është realizuar në vlerën **244 mijë lekë**

Gjithashtu, për vitin 2025, nga Ministria e Financave është alokuar fondi i veçantë prej **300 mijë lekë**. Ky fond është përdorur për ndihmë të menjëhershme rast fatkeqësie në vlerën 30 mijë lekë.

Nga zëri 606, në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025, u pakësua fondi prej 1,000 mijë lekë.

Shpenzimet faktike korrente (art.600-606) të lidhura me produktin “Inspektime të kryera dhe ankesa të trajtuara”, kodi 96301AA, për vitin 2025 me një total prej 224,400 mijë lekë , janë me një rritje prej 685 mijë lekë, ose me 0.3% në krahasim me vitin paraardhës dhe me një realizim në masën 98.33% të planit të buxhetit të rishikuar 2025.

“ Shpenzimet për investime ” (art.230-231)

Me ligjin 115/2024, në dispozicion të ILD -së u miratua një buxhet prej **51,700 mijë lekë** për shpenzimet kapitale për vitin 2025.

Me buxhetin e miratuar për vitin 2025, u mundësua realizimi i projekteve të investimeve si më poshtë:

- 1) Mobilimi i zyrave dhe ambjenteve me një fond të realizuar në vlerën 17,451.8 mijë lekë, kundrejt 25,000 mijë lekë që ishte buxheti i miratuar në ligj.
- 2) Ndërtimi i Sistemit të videokonferencave në sallën e mbledhjeve me realizim në vlerën 3,900 mijë lekë, nga 5,200 mijë lekë buxhet në dispozicion për këtë projekt.
- 3) Hartimi i projektit për ndërtimin e dhomës së serverave me fondin e realizuar në vlerën 475.2 mijë lekë.
- 4) Hartimi i projektit për ndërtimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në ILD në vlerën 597 mijë lekë.
- 5) Blerje pajisje informatike në vlerën 993 mijë lekë.

Në ligj, u miratua edhe fondi prej 18,200 mijë lekë për zbatimin e projektit për ndërtimin e dhomës së serverave, fond i cili nuk u realizua për shkak të vonësive të tejzgjatura nga ana e KPP në shqyrtimin e ankesave dhe marrjen e vendimeve për këtë procedurë prokurimi. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka ndërmarë të gjitha hapat ligjorë dhe procedural prej fillimit të muajit Prill 2025; pra prokurimi i këtij projekti ka filluar 9 (nëntë) muaj përpara përfundimit të vitit kalendarik 2025. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimet nr. 55/2026, datë 13.01.2026 dhe nr. 75/2026, datë 15.01.2026, sipas të cilave u vendos mospranimi i të dyja ankesave dhe lejimin e autoritetit kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Për shkak të rëndësisë shumë të madhe që ka realizimi i projektit, i cili lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e të gjitha sistemeve hardware dhe software të godinës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vlerësuar prioritar sigurimi i financimit të këtij projekti në buxhetin e vitit 2026 dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin ekonomik fitues të saj.

Në mbyllje të vitit buxhetor, realizimi në total i fondeve për shpenzimet kapitale ndaj planit fillestar është në vlerën 23,417 mijë lekë, ose në masën 45.3%, me një ndryshim vjetor (Plan-Fakt) prej 28,283 mijë lekë, e përbërë nga:

- ✓ Fonde të kursyera nga procedurat e prokurimit në vlerën 16,113 mijë lekë.
- ✓ Fondi i parealizuar deri në datën 31.12.2025 për projektin “Ndërtimi i dhomës së serverave”, në vlerën prej 12,170 mijë lekë (sipas ofertës ekonomike të shpallur fituese), në pritje të shqyrtimit dhe daljes me vendim përfundimtar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025, fondet e mbetura nga kursimet e procedurave të prokurimeve për projektet e miratuara, u pakësuan në total me 15,781 mijë lekë.

Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Për vitin 2025, me buxhetin e miratuar në ligjin 115/2024, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor dhe nisjen e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve ka realizuar *qëllimin e politikës së programit*, që është “garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

Në përmbushjen e objektivit të programit: “*Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane*”, ka ndikuar realizimi i treguesve të performancës, si :

- ✓ Rritja e standardeve me qëllim zhvillimin e procesit të hetimit disiplinor në përputhje me parimet e ligjshmërisë e të procesit të rregullt ligjor sipas standardeve ndërkombëtare, përmes ndjekjes së aktiviteteve trajnuese, pjesëmarrjes aktive në forume profesionale dhe zhvillimin e vizitave studimore në inspektoratet homologe evropiane. Gjatë vitit 2025 janë kryer 4 vizita studimore dhe takime me institucionet dhe org. ndërkombëtare. Për Njësine e Inspektorëve janë realizuar gjithsej 25 trajnime të organizuara nga institucionet përkatëse të trajnimit, nga të cilat 17 trajnime janë organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, 3 trajnime nga EU4Justice, 1 trajnim nga CEPEJ, 1 trajnim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, 2 trajnime nga Qendra Holandeze e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin (SSR – MATRA) dhe 1 trajnim nga Institucionet e Drejtësisë në Mbretërinë e Bashkuar. Për Njësinë e Ndihmës Inspektorëve janë zhvilluar gjithsej 26 trajnime, nga të cilat 21 trajnime janë organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, 2 trajnime nga programi EU4Justice, 1 trajnim nga CEPEJ dhe 2 trajnime nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë
- ✓ Përfundimi i 7 inspektimeve tematike, nga të cilat 3 inspektime tematike, pjesë e planit të inspektimeve të vitit 2024 dhe 4 inspektime tematike të planifikuara për vitin 2025, si dhe përfundimi i trajtimit të numrit prej 1480 të ankesave të mbartura nga viti 2024.

Produkti *“Inspektime të kryera/ ankesa të trajtuara” – kodi 96301AA*

- Inspektime të kryera

Inspektori i Lartë të Drejtësisë me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025, të “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025” ka miratuar planin e inspektimeve për vitin 2025, ku janë miratuar 9 (nëntë) inspektime, prej të cilave 8 (tetë) janë inspektime tematike dhe 1 (një) është inspektim institucional.

Gjatë vitit 2025 (janar-dhjetor):

- ✓ kanë përfunduar 4 (katër) inspektime tematike (pjesë e planit të miratuar për vitin 2025) dhe 3 (tre) inspektime tematike pjesë e planit të inspektimeve nga viti 2024
- ✓ janë në proces (4 (katër) inspektime tematike dhe 1 (një) inspektim institucional)

Gjithsej gjatë vitit 2025, kanë përfunduar 7 (shtatë) inspektime tematike.

- Ankesa të trajtuara

Gjatë këtij viti janë depozituar 1792 ankesa të reja të cilat, të shpërndara sipas subjekteve ankuese, janë:

- ✓ 1718 ankesa të depozituara nga persona fizikë;
- ✓ 74 ankesa të depozituara nga persona juridikë.

Në mbyllje të vitit 2024 janë mbartur për trajtim 1480 ankesa. Objekt shqyrtimi për vitin 2025 në total janë 3272 ankesa, duke përfshirë dhe ankesat e depozituara gjatë këtij viti.

Nga këto, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë vitit 2025, ka shqyrtuar 1635 ankesa, ose 315 ankesa më shumë në krahasim me vitin 2024.

Kosto faktike për njësi e produktit ***“Inspektime të kryera/ ankesa të trajtuara”*** – **kodi 96301AA** për vitin raportues, është në vlerën 136,662.49 lekë/njësi, me një deviacion prej (-) 31,626 lekë/njësi në krahasim me këtë tregues të raportuar në vitin 2024.

Përfundime:

Kufizimet e kuadrit ligjor në fuqi lidhur me procedurat e rekrutimeve për pozicionet “Inspektor magjistrat” dhe “Inspektor jo magjistrat”, kanë sjellë për pasojë vijimin e problematikës së funksionimit me 10 vende të plotësuara në trupën e inspektorëve, nga 20 të miratuara në organikë.

Kjo situatë, së pari krijon vështirësi për stafin aktual në përballimin e volumit të lartë të punës. Megjithatë, edhe pse në kushte mbingarkese, njësitë e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve janë angazhuar maksimalisht në ruajtjen e performancës së institucionit përsa i përket trajtimit një numri të lartë të kërkesave dhe ankesave të ardhura, si dhe në realizimin e inspektimeve tematike dhe atyre institucionale.

Nga ana tjetër, kjo problematikë, sjell shmangie të konsiderueshme të buxhetit të rishikuar ndaj buxhetit fillestar të miratuar në ligj. Kështu, për vitin 2025, buxheti i rishikuar i ILD në zërat “Paga” dhe “Sigurime” rezulton me devijacion në vlerën (-) 71,100 mijë lekë, ose me (-) 27% kundrejt planifikimit fillestar në këto zëra, për shkak të fondeve të lira të papërdorura.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periudha e Raportimit 12-2025

në/lekë

Emri i Grupit Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë				Kodi i grupit		63						
EMËRTIME		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
		Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese	Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve në %		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)		
Shpenzimet sipas programeve buxhetore												
Kodi i Programit	Emërtimi											
03320	Veprimtaria e Zyres se Inspektorit te Larte te Drejtësisë	361,859,391.50	100.00%	354,600,000.00	100.00%	264,119,000.00	100.00%	-90,481,000.00	247,817,172.50	100%	16,301,827.50	93.83%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap. 01,02,03,04,05,08,22)	361,859,391.50	100.00%	354,600,000.00	100.00%	264,119,000.00	100.00%	-90,481,000.00	247,817,172.50	100%	16,301,827.50	93.83%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0%	0.00	
	Totali Shpenzimeve te Ministrisë	361,859,391.50		354,600,000.00		264,119,000.00		-90,481,000.00	247,817,172.50		16,301,827.50	93.83%
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Artikulli	Emërtimi											
600	Paga	168,274,989.00	75.24%	235,300,000.00	77.68%	171,300,000.00	75.07%	-64,000,000.00	171,257,545.00	76.32%	42,455.00	99.98%
601	Sigurime Shoqërore	23,877,535.00	10.68%	31,400,000.00	10.37%	24,300,000.00	10.65%	-7,100,000.00	24,255,802.00	10.81%	44,198.00	99.82%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	31,059,653.51	13.89%	34,370,000.00	11.35%	32,070,000.00	14.05%	-2,300,000.00	28,612,602.50	12.75%	3,457,397.50	89.22%
603	Subvencione	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	
605	Transferta Korente të Huaja	0.00	0.00%	600,000.00	0.20%	0.00	0.00%	-600,000.00	0.00	0.00%	0.00	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	443,175.00	0.20%	1,230,000.00	0.41%	530,000.00	0.23%	-700,000.00	273,858.00	0.12%	256,142.00	51.67%
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	223,655,352.51	100.00%	302,900,000.00	100.00%	228,200,000.00	100.00%	-74,700,000.00	224,399,807.50	100.00%	3,800,192.50	98.33%
230	Kapitale të Patrupezuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	1,073,000.00	2.99%	1,073,000.00	1,072,206.00	4.58%	794.00	0.00%
231	Kapitale të Trupëzuara	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	34,846,000.00	97.01%	-16,854,000.00	22,345,159.00	95.42%	12,500,841.00	64.13%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	35,919,000.00	100.00%	-15,781,000.00	23,417,365.00	100.00%	12,501,635.00	65.19%
230	Kapitale të Patrupezuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	0.00%
	Totali Shpenzime Kapitale	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	35,919,000.00	100.00%	-15,781,000.00	23,417,365.00	100.00%	12,501,635.00	65.19%
	Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor	361,859,391.50	100.00%	302,900,000.00	100.00%	264,119,000.00	100.00%	-90,481,000.00	247,817,172.50	100.00%	16,301,827.50	93.83%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0.00		0.00		0.00		0.00	0.00		0.00	0.00%
	Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga te ardh.jashte limti	361,859,391.50		354,600,000.00		264,119,000.00		-90,481,000.00	247,817,172.50		16,301,827.50	93.83%
	Numri i punonjësve	83		101		101			82			

Sekretari i Përgjithshëm

Emri

Firma

Data


BESHIRA PASKO

15/02/2025

ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periodha e Raportimi 12-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periodha raportuese	Buxheti	Artikujt buxhetore									
					230	231	600	601	602	603	604	605	606	Total
			Periodike /Vjetore		Shpenzime Kapitale të Patrupezuara	Shpenzime Kapitale të Trupezuara	Pagat	Kontrib e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveçinet	Te Tjera Transfer. Korrente Brendshme	Transfer. Korrente të Huaja	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	Total
63	01	Nga Buxheti	2025	Plani fillestar	-	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	0	0	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00
63	01	Nga Buxheti	2025	Plani i rishikuar	1,073,000.00	34,846,000.00	171,300,000.00	24,300,000.00	32,070,000.00	0	0	-	530,000.00	264,119,000.00
63	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	1,072,206.00	22,345,159.00	171,257,545.00	24,255,802.00	28,612,602.50	0	0	-	273,858.00	247,817,172.50
63	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	-	-	-	-	21,199.00	0	0	-	-	21,199.00
63		Total	2025	Plani fillestar	-	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	0	0	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00
63		Total	2025	Plani i rishikuar	1,073,000.00	34,846,000.00	171,300,000.00	24,300,000.00	32,070,000.00	0	0	-	530,000.00	264,119,000.00
63		Total	2025	Fakti	1,072,206.00	22,345,159.00	171,257,545.00	24,255,802.00	28,612,602.50	0	0	-	273,858.00	247,817,172.50
63		Total	2025	Angazhime	-	-	-	-	21,199.00	0	0	-	-	21,199.00
63		Ndryshimi ne vlere absolute	2025		794.00	12,500,841.00	42,455.00	44,198.00	3,457,397.50	-	-	-	256,142.00	16,301,827.50
63		Realizimi ne %	2025			64.13%	99.98%	99.82%	89.22%	0.00%	0.00%	0.00%	51.67%	93.83%



Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Seri Rama	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	DESHIRI PASKI
	Firma			Firma	
	Data	16.02.2026		Data	16.02.2026



Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 605	Art. 606	Total
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Plani fillestar	-	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Plani i rishikuar	1,073,000.00	34,846,000.00	171,300,000.00	24,300,000.00	32,070,000.00	-	530,000.00	264,119,000.00
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Shpenzime faktike	1,072,206.00	22,345,159.00	171,257,545.00	24,255,802.00	28,612,602.50	-	273,858.00	247,817,172.50
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2025	Angazhime	-	-	-	-	21,199.00	-	-	21,199.00
63		Ndryshimi në vlerë absolute	2025		794.00	12,500,841.00	42,455.00	44,198.00	3,457,397.50	-	256,142.00	16,301,827.50
63		Realizimi në %	2025		99.93%	64.13%	99.98%	99.82%	89.22%	#DIV/0!	51.67%	93.83%
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani fillestar	-	51,700,000.00	235,300,000.00	31,400,000.00	34,370,000.00	600,000.00	1,230,000.00	354,600,000.00
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani i rishikuar	1,073,000.00	34,846,000.00	171,300,000.00	24,300,000.00	32,070,000.00	-	530,000.00	264,119,000.00
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Shpenzime faktike	1,072,206.00	22,345,159.00	171,257,545.00	24,255,802.00	28,612,602.50	-	273,858.00	247,817,172.50
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Angazhime	-	-	-	-	21,199.00	-	-	21,199.00
63		Numri i punonjësve në Total	2025	Plani fillestar								101
63		Numri i punonjësve në Total	2025	Plani i rishikuar								101
63		Numri i punonjësve në Total	2025	Numri faktik		..						82

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Seri Rama	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	DESHIRA PASKO
	Firma			Firma	
	Data	16.02.2026		Data	16.02.2026



ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

Periudha e Raportimit 12-2025

në/lekë

Emri i Grup		Veprimtaria e Mbiqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtesisë		Kodi i grupit		63						
Emri i programit		Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtesisë		Kodi i programit		03320						
EMËRTIME		Shpenzimet e Programit										
		Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese	Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve në %		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)		
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
	Emërtimi											
600	Paga	168,274,989.00	75.24%	235,300,000.00	77.68%	171,300,000.00	75.07%	(64,000,000.00)	171,257,545.00	76.32%	42,455.00	99.98%
601	Sigurime Shoqërore	23,877,535.00	10.68%	31,400,000.00	10.37%	24,300,000.00	10.65%	(7,100,000.00)	24,255,802.00	10.81%	44,198.00	99.82%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	31,059,653.51	13.89%	34,370,000.00	11.35%	32,070,000.00	14.05%	(2,300,000.00)	28,612,602.50	12.75%	3,457,397.50	89.22%
603	Subvencione	0.00	0.00%		0.00%	0.00	0.00%	-	0.00	0.00%	-	
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0.00%		0.00%	0.00	0.00%	-	0.00	0.00%	-	
605	Transferta Korente të Huaja	0.00	0.00%	600,000.00	0.20%	0.00	0.00%	(600,000.00)	0.00	0.00%	-	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	443,175.00	0.20%	1,230,000.00	0.41%	530,000.00	0.23%	(700,000.00)	273,858.00	0.12%	256,142.00	51.7%
	Nëntotali Shpenzime Korente	223,655,352.51	100.00%	302,900,000.00	100.00%	228,200,000.00	100.00%	-74,700,000.00	224,399,807.50	100.00%	3,800,192.50	98.33%
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0.00%	0	0.00%	1,073,000.00	2.99%	1,073,000.00	1,072,206.00	0.00%	794.00	99.93%
231	Kapitale të Trupëzuara	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	34,846,000.00	97.01%	(16,854,000.00)	22,345,159.00	0.00%	12,500,841.00	64.13%
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	35,919,000.00	100.00%	-15,781,000.00	23,417,365.00	0.00%	12,501,635.00	65.19%
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00		0.00		0.00		0	0.00	0.00%	0.00	0.00%
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00		0.00		0.00		0	0.00	0.00%	0.00	0.00%
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0	0.00	0.00%	0.00	0.00%
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	138,204,038.99	100.00%	51,700,000.00	100.00%	35,919,000.00	100.00%	-15,781,000.00	23,417,365.00	0.00%	12,501,635.00	65.19%
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	361,859,391.50	100.00%	354,600,000.00	100.00%	264,119,000.00	100.00%	(90,481,000.00)	247,817,172.50	100.00%	16,301,827.50	93.83%
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0.00%		0.00%		0.00%		0.00		0	
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0.00%		0.00%		0.00%		0.00		0	
	Totali i Shpenzimeve të Programit	361,859,391.50	100.00%	354,600,000.00	100.00%	264,119,000.00	100.00%	-90,481,000.00	247,817,172.50	100.00%	16,301,827.50	93.83%
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor												
Artikulli	Emërtimi											
	Totali i Shpenzime Korente	223,655,352.51	61.81%	302,900,000.00	85.42%	228,200,000.00	86.40%	-74,700,000.00	224,399,807.50	90.55%	3,800,192.50	98.33%
Kodi i produktit	Emërtimi											
96301AA	Inspektime të kryera / Ankesa të trajtuara	223,655,352.51	100.00%	302,900,000.00	100.00%	228,200,000.00	100.00%	(74,700,000.00)	224,399,807.50	100.00%	3,800,192.50	98.33%
	Totali Shpenzime për Investime	138,204,038.99	38.19%	51,700,000.00	14.58%	35,919,000.00	13.60%	-15,781,000.00	23,417,365.00	9.45%	12,501,635.00	65.19%
Kodi i produktit	Emërtimi											
18AB202	Blerje Licensash	0.00	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	0	0.00	0.00%	-	0.00%
M630020	Blerje automjetesh	6,492,000.00	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	0	0.00	0.00%	-	0.00%
M630001	Blerje Pajisje zyre	1,999,180.00	1.45%	25,000,000.00	48.36%	17,452,000.00	48.59%	-7,548,000	17,451,760.00	74.52%	240.00	0.00%
25AC801	Hartim projekti për ndërtimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe dokumenteve	0.00	0.00%	1,200,000.00	0.00%	597,000.00	0.00%	-603,000	597,000.00	2.55%	-	
M630013	Blerje pajisje kompjuterike	0.00	0.00%	2,100,000.00	0.00%	994,000.00	0.00%	-1,106,000	993,399.00	4.24%	601.00	
M630008	Rikonstruksione	129,712,858.99	93.86%	-	0.00%	-	0.00%	0	0.00		-	0.00%
18AB203	Ndërtimi i dhomes së serverave	0.00	0.00%	18,200,000.00	0.00%	12,976,000.00	0.00%	-5,224,000	475,206.00	2.03%	12,500,794.00	0.00%
18AR204	Sistem i videokonferencave në sallën e mbledhjeve	0.00	0.00%	5,200,000.00	0.00%	3,900,000.00	0.00%	-1,300,000	3,900,000.00	16.65%	-	0.00%

	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	138,204,038.99	95.30%	51,700,000.00	48.36%	35,919,000.00	48.59%	-15,781,000.00	23,417,365.00	100.00%	12,501,635.00	0.00%
Kodi i produktit	Emertimi											
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00	0.00%	0	0.00%
Kodi i produktit	Emertimi											
Kodi i produktit	Emertimi											
	Totali i Shpenzimeve të Programit	361,859,391.50	0	354,600,000.00	0	264,119,000.00	0	-90,481,000.00	247,817,172.50	0	16,301,827.50	93.83%

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri:	Seri Rama	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	DESHIRA PASKO
	Firma			Firma	
	Data	16.02.2026		Data	16.02.2026



ANEKSI nr.3 Raporti i performancës së produkteve të programit

Periodha e Raportimit 12-2025

në/lekë

Emri i Grupit	Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë					Kodi i grupit		63									
Emri i	Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë					Kodi i programit		03320									
Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Njësia matëse	Viti paraardhës			Periodha Rapotuese			Periodha Rapotuese			Periodha Rapotuese			Deviacioni i Kostos per Njësi		
			Sasia Faktike (Viti paraardhës)	Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës)	Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës)	Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor)	Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor)	Kosto për Njësi (sipas planit Fillestar të vitit)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Kosto për Njësi(sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Sasia Faktike (në /nfund të vitit korent)	Shpenzimet Faktike /n(në fund të vitit korent)	Kosto për Njësi Faktike n/(në fund të vitit korent)	13=(12)-(3)	14=(12)-(6)	15=(12)-(9)
			(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)
Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit															0	0	-
96301AA	Inspektime te kryera / Ankesa te trajtuara	Numër ankesash te shqyrtuara dhe	1329	223,655,352.51	168,288.45	1,200	302,900,000.00	252,416.67	1,200	228,200,000.00	190,166.67	1642	224,399,807.50	136,662.49	(31,625.96)	(115,754.18)	(53,504.18)
M630008	Rikonstruksione	Nr	1	129,712,858.99	129,712,858.99	0	-	-	0	-	-	0	-	-	(129,712,859)	-	-
M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Nr	0	-	-	14	2,100,000.00	150,000.00	14	994,000.00	71,000.00	12	993,399.00	82,783.25	82,783	(67,216.75)	11,783.25
M630020	Blerje automjete	Nr	2	6,492,000.00	3,246,000.00					-							
M630001	Blerje pajisje zyre	Nr	21	1,999,180.00	95,199.05	393	25,000,000.00	63,613.23	350	17,452,000.00	49,862.86	350	17,451,760.00	49,862.17	(45,337)	(13,751.06)	(0.69)
I8AB203	Ndërtimi i dhomes së serverave	Nr	0			1	18,200,000.00	-	1	12,976,000.00	12,976,000.00	1	475,206.00	475,206.00	475,206	475,206.00	(12,500,794.00)
18AB204	Sistem i videokonferencave në sallën e mbledhjeve	Nr	0			1	5,200,000.00	5,200,000.00	1	3,900,000.00	3,900,000.00	1	3,900,000.00	3,900,000.00	3,900,000	(1,300,000.00)	-
25AC801	Hartim projekti per ndërtimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe dokumenteve	Nr	0			1	1,200,000.00	1,200,000.00	1	597,000.00	597,000.00	1	597,000.00	597,000.00	597,000	(603,000.00)	-
T	Total			361,859,391.50			354,600,000.00			264,119,000.00			247,817,172.50				

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Seri Rama	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	DESHIRA PASKO
	Firma			Firma	
	Data	16.02.2026		Data	16.02.2026